



Pranim / Dorezuar / Primen / Prodato / Dostavio / Delivered	06.12.2023	3	viti / god / year
Organ / Ajsia / Organ / Jednica / Org / Unit	Nr Prot / Br Prot / Prot No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SPAMSHICK	7341	/2023	1/3



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1339/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin e dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga; Arben Mehmeti, kryetar, Malsore Gashi -Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.1339/2023 të datës 27.10.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë ,rruga _____", fsh Mikushnicë, Komuna e Skenderajt, kundër organit të punësimit Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike "Vlerësim i Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 06.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË, si e palejuar ankesa me numër A.nr.1339/2023 e datës 27.10.2023 e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi, _____, më datë 27.10.2023, me numër protokollit 6709/2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor lidhur me vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 02.11.2023, përmes E-mailit ka bënë kërkesë për përgjigje në ankesë te Agjencia Kosovare e Privatizimit, ndërsa më datë 07.11.2023, Agjencia Kosovare e Privatizimit, ka dërguar përgjigjen në ankesë në lidhje me ankesën e ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin në vijim Kolegji i këshillit), pas shqyrtimit të gjitha shkresave të bashkëngjitura në lëndë, konstatoi se ankesa e ankuesit Sefer Shabani, është e pa lejuar, sepse:

Kolegji i këshillit, konstaton se ankuesi mbanë pozitën e Zyrtarit Ligjor për Shqyrtimin e Dokumenteve të Shitjes, pozitë e shërbimit civil sipas akt emërimit me nr.refer.187/DSH7 të datës 28.12.2022 ,ndërsa duke shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i tij nuk ja ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022, bazuar në shkresat e lëndës që ndërlidhen me ankesën e ankuesit ka konstatuar se ankuesi ankesën e datës 27.10.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me legjislacionin në fuqi që rregullon këtë çështje e që do të elaborohet më hollësisht më poshtë.

Nga ajo që u tha më lartë dhe ndërlidhur me ankesën e parashtruar në Këshilli, Kolegji i këshillit, mori për bazë edhe nenin 43, paragrafi 1, të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (Ligj që ka qenë në fuqi në periudhën kur i ka lindë e drejta ankuesit të ushtroj mjetet juridike për realizimin e së drejtës së caktuar që ndërlidhet me këtë objekt të kësaj ankese)ku përcaktohej se; *"1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues"*, nenin 13, paragrafi 1,2,3, të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se; *"1. Nëse nëpunësi civil nuk pajtohet me vlerësimin përfundimtar të mbikëqyrësit, ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil. 2. Ndërsa nëpunësi i shërbimit publik ka të drejtë ankese në Komisionin e ankesave të institucionit.3. Afati për ushtrimin e ankesës së në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni është tridhjetë (30) ditë nga dita e marrjes së formularit të vlerësimit nga nëpunësi"*, dhe konstaton se referuar dispozitave të potencuara si më lartë ankuesit i ka lindë e drejta që të ushtroj mjetet juridike nga momenti përfundimit të vlerësimit për vitin 2022 përkatësisht pas datës 31 Janar 2023 ,e në rastin konkret ankuesi ka parashtruar ankesën për mos vlerësim të rezultateve në punë për vitin 2022, më datë 27.10.2023.

Kolegji i këshillit ndërlidhur me çështjen si më lartë, konstaton specifikisht se ankesa e ankuesit në këshill është parashtruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: *"1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ"*, përkatësisht ankesa e ankuesit e datës 27.10.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e pasafatshme, ngase e njëjta është parashtruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi që ndërlidhet me këtë çështje përkatësisht të drejtës së ankesës, sikurse që nuk është përmbushur as kriteri kohor ndërlidhur me heshtjen administrative si mjete juridike të realizimit të një të drejte të caktuar, poashtu ankesa është parashtruar edhe në kundërshtim me nenin 24, paragrafi 3 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë(Ligj i aplikuar në këtë periudhë që ndërlidhet me të drejtën e caktuar që është objekt i kësaj ankese), ku përcaktohej se; *"3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankese drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji"*, gjithnjë duke respektuar procedurat dhe afatet ligjore që ndërlidhen me këtë çështje që është objekt i kësaj ankese.



Bazuar në at që u tha si më lartë sa i përket mos vlerësimit të ankuesit të rezultateve në punë për vitin 2022, Kolegji i këshillit ka konstatuar se ankuesi ka qene i obliguar që ankesën për mos vlerësim të punës për vitin 2022 ta parashtrojë në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë(Ligj i aplikuar në këtë periudhë që ndërlidhet me të drejtën e caktuar që është objekt i kësaj ankese), Rregulloren Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, andaj mbi këtë bazë ankesa në këshill është e parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me legjislacionin që rregullon këtë çështje dhe se mbi këto arsye ligjore ankesa u hodh poshtë si e palejuar, rrjedhimisht kolegji i këshillit nuk u lëshua në trajtim të pretendimeve që ndërlidhen me objektin e kësaj ankese për arsyet e potencuara në arsyetim të këtij vendimi.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, Prishtinë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.1339/2023, datë 06/12/2023

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

